To answer all these questions, four things should constantly be involved such as: putting words in storage through the ear, through the eye, keeping words in storage, retrieving, and using them.

The processing of words at different levels is crucial to learning. The different levels include integration in the learning process of pronunciation, the visual shape of the grammatical structure and semantic patterns of the word.

## **A systematic approach to vocabulary teaching**

A language teacher needs to find systematic ways of helping learners with the vocabulary. A systematic approach might devote lesson time to helping learners at each of the following stages of learning vocabulary when the learners:

- Meet new words and understand their meaning(s) and the ways they are used;
- Practise using the words;
- Find ways that help them memorize the words;
- Recall and use the words appropriately.

The teacher in the classroom can help learners understand the meaning by:

- Avoiding language more complex than the word s/he is trying to explain;
- Focusing on the most important usages;
- Using examples;
- Using teachers own and learner's knowledge and feelings to focus on what we understand by this word.

At level 2 they are beginning to read independently selecting simple texts and using a bilingual dictionary or glossary to look up new words. When reading on their own they are beginning to use context to work out what unfamiliar words mean etc.

1	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
Level 1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• To recycle words appropriately;</li> <li>• To act or mime words;</li> <li>• To focus learners' attention on pronunciation.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• To imitate, follow orders and respond;</li> <li>• To listen and pick up things correctly;</li> <li>• To match words and pictures.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Matching pictures to words;</li> <li>• Miming;</li> <li>• Listen, read and say.</li> </ul>

### The Role of Grammar

If we see language as a building, the words as building blocks or bricks, and grammar as the architect's plan, than we must admit that without a plan, even a million bricks do not make a building. Similarly, one may know a million English words, but if s/he does not know how to put them together, s/he cannot speak English ( Sesnan, 1997).

In the light of this statement, the question is not whether to teach grammar or not, but *how* to teach it. We should consider which approach to adopt in teaching grammar, whether to teach form before meaning, or meaning before form, and what strategies and techniques to use in order to enable learners to put their knowledge of grammar into use and communicate effectively. It is the teacher's responsibility to estimate which approach would yield best effects at a particular stage of learning, or with a particular class.

	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
Level 1	<ul style="list-style-type: none"> <li>To expose learners to particular language items;</li> <li>To offer appropriate examples;</li> <li>To provide opportunities for restricted use of language items;</li> <li>To make activities playful and enjoyable.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Grasp the meaning of the language items;</li> <li>Show readiness to participate in activities;</li> <li>Practice language items in communicative activities.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Demonstration;</li> <li>Games;</li> <li>Songs;</li> <li>Magic tricks;</li> <li>Drawing.</li> </ul>

According to the findings of the authors mentioned above, at this level, learners should be able to recognize different word categories and put words into phrases. They may also be able to combine phrases in order to form sentences. They should be able to deal with both Yes/No questions and WH-questions. At this level, learners may be able not only to grasp the meaning of language items, but also to understand particular aspects of the language system. Developing their cognitive and meta-cognitive skills, learners should be able to understand and use the rules of grammar. Regardless of this, teachers should be careful, when discussing explicitly and explaining the grammar, not to overdo, that is not to lecture on grammar. Instead, they should demonstrate grammar through substitution tables, or drills incorporated within communicative activities.

### Assessment and Evaluation

There are many reasons for assessing learners. Some of them are:

- to compare learners with each other;

- to see if learners have reached a particular standard;
- to help the learners' learning;
- to check if the teaching programme is successful.

Teaching means changing the learner. Teachers will always want to know how effective their teaching has been- that is, how much their pupils have changed.

This change can be in:

- The amount of English learners know;
- The quality of the English they use;
- Their ability to use English.

The general word for measuring the change is assessment. Naturally if we want to assess how much pupils have changed, we have to know exactly what they already **know** and what they can already **do**.

There are different types of assessment (or evaluation):

**Self assessment (self - evaluation)** relies on:

- The amount of effort expended in research;
- The amount of effort expended on initial organization;
- The amount of organization;
- The amount of effort spent on writing.

**Group assessment (group - evaluation)** can be done by:

- Evaluating individual learner progress within the group;
- Awarding group and individual marks.

This fosters cooperation among the learners, they promote higher achievement, greater motivation, and a more positive attitude towards the subject area and greater social skills.

**Individual assessment (evaluation)** is more readily accepted by learners, shows learners activity, his/her participation level in the group activity, willingness to respect the viewpoints of others.



**Combination of group and individual assessment** - the group component may foster the spirit of cooperation, and the individual component may permit the recognition of individual contributions.

**The use of work samples, portfolios and projects.** These folders or portfolios may be used to collect samples of a range of learners' work over the course of a term or a year. All these may reflect the learners' overall development and show learners' progress.

If teachers want to find out how effective their teaching has been, or if they want to evaluate the learners' progress the tests are used. Tests are conducted in class by the teacher. They measure the results of learners' performance. Teaching and testing always go hand-in-hand. Questions are often asked to check if the learners have understood what has been said. Equally, they may be asked to find out whether a particular point needs to be taught. We instinctively know why we ask a question: whether it is to teach or to test something.

Some major reasons for testing are:

- To diagnose learners' standard on arrival;
- To measure learners' progress;
- To find out how much pupils have learned;
- To find out the quality of learning;
- To find out how many of the class have learned what they were supposed to learn;
- To motivate pupils;
- To show the teacher what to teach next.

There are different kinds of tests, such as:

- **Proficiency tests** to examine a general standard in ability, regardless of the teaching programme;
- **Achievement tests** that examine whether learners can do what they have been taught, either by testing specific syllabus items or general objectives;
- **Placement tests** are a mixture of the above two, depending on what criteria we use to place the learner;

- **Diagnostic tests** use **proficiency** or **achievement tests** to analyse strengths and weaknesses in the learner or the teaching programme itself.

We see **evaluation** as wider than testing. Testing may be a successful tool in evaluation, but we also think there are other criteria for assessing someone's performance. Evaluation is not limited to numbers or just giving learners marks. Instead of trying to count or measure learner's ability to make useful contribution to the class, we can simply judge whether s/he makes a contribution or not, and sometimes we will have to justify, negotiate, and possibly modify our opinions.

Evaluation looks for illumination: How did you learn that? Why did you learn that? This means that we are doing something **with** the learner, rather than **to** the learner. By asking these questions, we will learn a lot of extra information, such as:

- What the learner thinks s/he is learning;
- What the learner thinks is easy / difficult;
- What the learner enjoys / hates doing in the class;
- Where the teaching programme and the learner don't meet;
- Where the teaching programme need re-designing.

With the evaluation we are trying to help the learner to learn, so it is not an assessment, in fact it is aid to learning. In other words, we can use assessment procedure to develop and improve, not only the learner, but also the teaching programme and even the school.

### Band Descriptors for Assessing Language Skills

Band	Listening	Speaking		Reading	Writing
		Fluency	Accuracy		
5	Can understand all the message	Does task very well. Little or no hesitation	Good pronunciation, use of vocabulary and grammar	Can understand all the text	Work is well organised. Good punctuation. Few or no mistakes
4	Can understand most of the message	Does the task well. Some hesitation	Good pronunciation, vocabulary and grammar. A few mistakes	Can understand most of the text	Work is mostly well organised. Good punctuation. A few mistakes
3	Can understand some of the message	Does the task adequately. Quite a lot of hesitation	Pronunciation, vocabulary and grammar are adequate. Quite a lot of mistakes but it is possible to understand the learner	Can understand some of the text	Some problems with the message and/or punctuation and/or organisation, but it is possible to understand the message
2	Can understand a little bit of the message	Does not do the task adequately. A lot of hesitation	Pronunciation, vocabulary and grammar are limited. It is difficult to understand the learner	Can understand a little bit of the text	Problems with the message and/or punctuation and/or organisation. It is difficult to understand the message
1	Can understand very little of the message	Is not really able to do the task at all	Very hard or impossible to understand the learner.	Can understand very little or none of the text	Significant problems with the message and/or punctuation and/or organisation. It is almost impossible to understand the message

The table above sets out bands which describe levels of achievement in the four skills. This band descriptors are intended to apply to specific tasks (e.g. listening to a story, talking about a picture, reading about an invention, writing a letter), as an aid to the teacher and learner in assessing performance. It is of course perfectly possible for a learner to perform to different bands of achievement for different task and different skills.

# MATEMATIKË

(5 orë në javë, 90 orë në vit)

## HYRJE

Në shekullin XXI matematika gjithnjë e më tepër po zë një vend qendror jo vetëm në studimin e fenomeneve natyrore dhe teknike, por ajo me ndërtimin e saj të argumentuar e logjik zë vend qendror në arsimimin e përgjithshëm të individit. Në kuptimin më të përgjithshëm, mësimi i matematikës i kushtohet njohjes më precize të botës në të cilën jetojmë. Duke mësuar matematikën, individi aftësohet për një përceptim më real të fenomeneve që e rrethojnë ate dhe njëkohësisht aftësohet që më me lehtësi të arrijë në përfundime logjike për të zgjidhur edhe shumë probleme jetësore e shoqërore. Prandaj, lënda e matematikës paraqet njërën ndër lëndët e arsimimit të përgjithshëm në shkollën fillore, me detyra të shumëfishta arsimore-informative dhe edukative.

Të mësuarit e matematikës te nxënësit:

- nxit kureshtjen, kreativitetin dhe zhvillimin e mendimit logjik. Me përmbajtjet e para matematike fillon rruga drejt mendimit abstrakt dhe kritik;
- zhvillon aftësitë krijuese si dhe kuptimin për harmonin - kjo arrihet gjatë studimit të numrave, veprimeve aritmetike me ta, krahasimit të madhësive dhe formave të ndryshme gjeometrike;
- paraqet një aspekt të rëndësishëm moral dhe social, sepse nxënësit arrijnë në përfundime të sakta dhe në zbulime të cilat kërkojnë shprehje precize. Me këtë rast ata ndeshen dhe vlerësojnë mendime të ndryshme, të cilat do të shërbejnë për zhvillimin e kulturës së të menduarit kritik;
- zhvillon njohuritë dhe shkathtësitë për të shtruar dhe kuptuar drejt problemet edhe në fushat e tjera të mësimt;
- krijon një bazë solide për të thelluar njohuritë në shumë fusha të tjera, kur kihet parasysh fakti se matematika paraqet gjuhën e shumë shkencave dhe disiplinave të tjera.

Nxënësi në klasën e parë dhe të dytë ka arritur një shkallë të njohurive lidhur me kuptimet themelore të matematikës (p.sh., kuptimin e bashkësisë, relacionit, numrit dhe kuptimet e ndryshme gjeometrike), në klasën e tretë do të duhej të zgjeroheshin kërkesat për një avancim të diturive të tij. Matematika në klasën e tretë, në masë të gjerë, është e lidhur me po të njëjtat koncepte nga klasa e parë dhe e dytë, por në një formë më të zgjeruar në aspektin përmbajtësor. Do të duhej të zgjedhen ushtrime ku kërkohet një shkathtësi më e madhe mendore. Sikurse në klasën e dytë duhet të ekzistojë synimi i mësimdhënësve të zhvillojnë aftësitë të nxënësit për të vërejtur ngjashmëritë dhe dallimet në forma dhe raporte si dhe aftësitë për të bërë krahasime. Për të arritur këtë synim do të duhej që gjatë mësimdhënies të futen në funksion sa më shumë metodologjitë e reja të mësimdhënies.

## **QËLLIMET**

Programi i lëndës së matematikës për klasën e tretë ka për qëllim:

- Të zhvillojë te nxënësit imagjinatën, kureshtjen, vëmendjen, kujtesën dhe intuitën;
- Të aftësojë nxënësit të shprehën drejt, qartë dhe saktë;
- Kultivimin e vetiniciativës, punës së pavarur dhe bashkëpunimit;
- Të aftësojë nxënësit që dituritë e fituara t'i zbatojnë në situata të ndryshme nga jeta e përditshme;
- Aftësimin e nxënësve që dituritë e fituara t'i shfrytëzojnë në mësimin e matematikës dhe të lëndëve të tjera në nivelet më të lartë të shkollimit.

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Nga përmbajtja programore e klasës së tretë nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- Të kryejë veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave 1-1000 si dhe të dijë t'i paraqesë numrat thyesorë në boshtin numerik.
- Të zbatojë dituritë e fituara në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga jeta e përditëshme.

- Të zgjidhë barazime dhe jobarazime të thjeshta numerike dhe t'i zbatojë ato në zgjidhjen e problemeve konkrete.
- Të dallojë figurat e ndryshme gjeometrike në rrafsh (sipërfaqet trekëndëshe, katërkëndëshe, pesëkëndëshe dhe gjashtëkëndëshe); numrin e kulmeve, brinjëve dhe këndeve të tyre.
- Të dallojë trupat gjeometrikë (kubin, kuboidin, kuadrin, prizmin, piramidën) si dhe faqet, brinjët dhe qoshet (këndet) e tyre.
- Të vizatojë me vizore vija dhe figura të ndryshme.
- Të njohë njësitë për matjen e gjatësive (m, dm, cm), masës (kg), njësitë për matjen e kohës dhe njësitë monetare (€).
- Të mbledhë dhe të sistematizojë të dhëna të thjeshta.

PLANIFIKIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE			
KATEGORITË	NËNKATEGORITË	Nr. i orëve	%
<b>1. Bashkësitë</b>	<b>Bashkësitë</b>	8	8,8
	<b>Relacionet</b>		
<b>2. Aritmetika dhe algjebra</b>	<b>Numrat natyrorë deri në 1000</b>	51	56,6
	<b>Veprimet me numra 1-1000 dhe vetitë e veprimeve</b>		
	<b>Barazimet dhe jobarazimet</b>		
<b>3. Gjeometria dhe matjet</b>	<b>Drejtëzat</b>	23	25,5
	<b>Format gjeometrike</b>		
	<b>Matjet</b>		
<b>4. Përpunimi i të dhënave</b>	<b>Përpunimi i të dhënave</b>	8	8,8

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT DHE REZULTATET E PRITSHME

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme
<b>1. Bashkësitë dhe relacionet</b>	<b>1.1. Bashkësitë 1.2. Relacionet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqitja e bashkësisë me emërtim të elementeve, me anën e kllapave gjarpërore; me tabela.</li> <li>• Kuptimi i nënbashkësisë.</li> <li>• Pasqyrimi.</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të paraqesë bashkësitë, duke përdorur kllapat gjarpërore dhe me anë të tabelave;</li> <li>• Të formojë nënbashkësi të bashkësisë së dhënë, duke veçuar elementet sipas ndonjë cilësie;</li> <li>• Të kuptojë nocionin e pasqyrimin</li> </ul>
<b>2. Aritmetika dhe algjebra</b>	<b>2.1. Numrat natyrorë deri në 1000 2.2. Veprimet me numra 1-1000 dhe vetitë e veprimeve 2.3. Barazimet dhe jobarazimet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrat deri në një mijë; kuptimi i numrave të tillë; leximi (emërtimi) dhe shkrimi i numërorëve deri 1000.</li> <li>• Krahasimi dhe renditja e numrave deri 1000 (shenjat <math>&lt;</math>, <math>=</math>, <math>&gt;</math>); paraqitja e tyre në boshtin numerik.</li> <li>• Njësitë dhjetore (njëshet, dhjetëshet, qindëshet).</li> <li>• Mbledhja dhe zbritja e numrave deri 1000 pa kalim, përkatësisht, pa prishje të dhjetëshes dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë dhe të shkruajë drejt dhe saktë numrat natyrorë 1-1000;</li> <li>• Të kryejë mbledhjen dhe zbritjen e numrave 1-1000 pa kalim, përkatësisht, pa prishje të dhjetëshes dhe të qindëshes;</li> <li>• Të kryejë zbritjen e numrave 1-1000 me kalim, përkatësisht me prishje të dhjetëshes dhe të qindëshes;</li> <li>• Të krahasojë dhe të renditë numrat 1-1000, duke i paraqitur në boshtin numerik dhe duke përdorur shenjat <math>&lt;</math>, <math>=</math>, <math>&gt;</math>, ...;</li> <li>• Të kryejë shumëzimin e numrave njëshifror dhe të numrave njëshifrorë me dyshifror, në rresht dhe në shtyllë;</li> <li>• Të kryejë pjesëtimin e numrave dy shifrorë</li> </ul>

		<p>qindëshes.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledhja dhe zbritja e numrave deri 1000 me kalim, përkatësisht, me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes.</li> <li>• Shumëzimi jashtë tabelës. (Shumëzimi duke shfrytëzuar vetinë e përdasimit; vetia e shoqërimit; shumëzimi i numrit dyshifror me numër njëshifror; shumëzimi i numrave dyshifror; shumëzimi i numrave treshifror me numër njëshifror).</li> <li>• Zgjidhja e barazimeve <math>a &lt; b</math> dhe <math>a \leq b</math>.</li> <li>• Pjesëtimi jashtë tabelës; vetia e përdasimit të pjesëtimit; pjesëtimi i numrave dyshifror e treshifrorë me një numër njëshifror).</li> <li>• Numrat racionalë. Thyesat si numërorë që tregojnë</li> </ul>	<p>me numrat njëshifrorë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojë thyesat si numrorë që tregojnë pjesë të barabarta të tërësisë <math>(\frac{1}{2}, \frac{1}{3}, \frac{2}{3}, \frac{3}{4}, \frac{4}{4})</math>; numërorët thyesorë që tregojnë të njëjtin numër <math>(\frac{1}{2}, \frac{2}{4}, \frac{3}{6})</math>;</li> <li>• T'i paraqesë numrat thyesorë në boshtin numerik;</li> <li>• Të zgjidhë barazimet dhe jobarazimet e formës <math>a = b</math>, <math>a &lt; b</math>, <math>a &gt; b</math>, <math>-a &lt; b</math>, <math>-a &gt; b</math>, dhe t'i zbatojë ato në detyra të thjeshta me fjalë.</li> </ul>
--	--	--	---



		<p>pjesë të barabarta të tërësisë <math>(\frac{1}{2}, \frac{1}{3}, \frac{2}{3}, \frac{3}{4}, \frac{4}{4})</math>; Numërorët thyesorë që tregojnë të njëjtin numër <math>(\frac{1}{2}, \frac{2}{4}, \frac{3}{6})</math>.</p> <p>Paraqitja e numrave thyesorë në boshtin numerik.</p>	
<p><b>3. Gjeometria dhe matjet</b></p>	<p><b>3.1. Drejtëzat</b>  <b>3.2.Format gjeometrike</b>  <b>3.3. Matjet</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtëzat normale (pingule) dhe paralele.</li> <li>• Shumëkëndëshat (si vija të thyera të mbyllura) trekëndëshat, katërkëndëshat, peskëndëshat, gjashtëkëndëshat; numri i kulmeve, i brinjëve dhe i këndeve të tyre.</li> <li>• Sipërfaqet shumëkëndëshe (si pjesë të rrafshit të kufizuar me shumëkëndëshat)-sipërfaqet trekëndëshe, sipërfaqet katërkëndëshe, sipërfaqet peskëndëshe, sipërfaqet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të caktojë segmentet në drejtëz, duke bërë bartjen me kompas nga vija e thyer;</li> <li>• Të dallojë drejtëzat normale (pingule) dhe drejtëzat paralele;</li> <li>• Të dallojë trekëndëshat, katërkëndëshat, pesëkëndëshat, gjashtëkëndëshat si dhe sipërfaqet përkatëse; të caktojë numrin e kulmeve, të brinjëve dhe të këndeve të tyre;</li> <li>• Të gjejë perimetrat e shumëkëndëshave, duke bërë matjen e gjatësive të brinjëve me anë të vizores;</li> <li>• Të dallojë kubin, kuadrin, prizmin, piramidën dhe të caktojë numrin e brinjëve, faqeve dhe qosheve (këndeve) të tyre;</li> <li>• Të dallojë figurat e përputhshme (kongruente);</li> </ul>

		<p>gjashtkëndëshe; kulmet, brinjët dhe këndet e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trupat gjeometrikë. Kubi, kuboidi (kuadri), prizmi, piramida; faqet, brinjët dhe qoshtet (këndet) e tyre.</li> <li>• Përputhshmëria (kongruenca) e figurave gjeometrike.</li> <li>• Matja e gjatësive (njësitë m, dm, cm).</li> <li>• Matja e masave (njësitë kg, hkg, dkg.)</li> <li>• Perimetri i shumëkëndëshit (duke bartur brinjët e tij me kompas ose duke matur ato).</li> </ul>	
<b>4. Përpunimi i të dhënave</b>	<b>4.1. Përpunimi i të dhënave</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqitja e të dhënave me tabelë.</li> <li>• Leximi i të dhënave nga tabelat.</li> <li>• Situata të thjeshta kombinatorike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të paraqesë të dhënat me anë të tabelave, shtyllave dhe t’i lexojë ato.</li> <li>• Të zgjidhë probleme të thjeshta kombinatorike.</li> </ul>

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Shkolla duhet të shërbejë për ngjalljen dhe ruajtjen e interesimit të nxënësve për matematikën dhe gradualisht ta zhvilloj atë.

- Mësimi i matematikës, posaçërisht në vitet e para, nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në esencë edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë të ofrohet duke u shërbyer me lojëra, eksperimente dhe situata reale nga jeta e përditshme.
- Mënyra e të nxënësve të dijës duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat matematike nuk është e mundshme që për një herë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që çdo herë të lidhen dhe të gërshetohen tërësitë e vogla të përmbajtjeve në tërësi më të mëdha në atë mënyrë që duke futur përmbajtjen e re të përvetësohen dhe të përforcohen sa më shumë përmbajtjet paraprake.
- Motivimi është çelës i të mësuarit të matematikës. Andaj, mjeshtria e mësimdhënësit për motivimin e nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike është me rëndësi të posaçme. Kjo arrihet me zgjedhjen e ushtrimeve të përshtatshme, të cilat nxisin të menduarit logjik të nxënësit.
- Në klasën e tretë do të duhej të avancohen njohuritë e nxënësve sa i përket veprimeve me numra dhe paraqitjes së tyre në boshtin numerik. Andaj, detyrë e mësimdhënësit është të gjejë mënyrën dhe të zgjedhë teknikat përkatëse të mësimdhënies. Këtë mund ta arrijë me mësimin e individualizuar, me punën në grupe të vogla etj.
- Duhet pasur kujdes që gjatë ushtrimeve, nxënësit të stimulohen të zgjidhin detyra konkrete nga jeta e përditshme, sa herë që një mundësi e tillë ekziston. Në këtë mënyrë nxënësit do të kuptonin në vazhdimësi rolin e matematikës. Po që se është e mundur, do të ishte mirë të ofrohen sa më shumë variante të zgjidhjes së detyrave.
- Qëllimi i të mësuarit të matematikës nuk është në arritjet rutinore, të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve por përvetësimi me themel i materies. Duhet të kihet parasysh që fondi i njohurive dhe i shkathësive të arritura gjithmonë të jetë në dispozicion të nxënësit.

- Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e mjaftueshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

Për të arritur rezultatet optimale në fushën e mësimdhënies së matematikës, rëndësi të jashtëzakonshme luan hartimi i programit të mirë, i teksteve të mira, trajnimi i mirë i mësimdhënësve si dhe përdorimi i metodave dhe i teknikave përkatëse të mësimdhënies në pajtim me kushtet dhe rrethanat në të cilat zhvillohet mësimi.

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë e cila shërben për të gjykuar mbi shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore dhe standardet e arritshmërisë të precizuara me program.

### **Nivelet e arritshmërisë**

Shkalla e arritshmërisë së nxënësve vlerësohet duke u bazuar kryesisht në tri nivele:

**Niveli I.** -Përfshin arritshmërinë minimale, që d.m.th. paraqet minimumin e domosdoshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore e që në përqindje do të shprehej me 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimdhënësit me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e mësuesit si dhe komunikojnë për njohuritë matematike duke pasur

gjithmonë këtë ndihmë.

**Niveli II.**- Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehura në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimdhënësit, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe të metodave, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

**Niveli III.**- Është niveli më i lartë apo niveli i avancuar (maksimal) i arritjes së nxënësve i shpehur në përqindje (mbi 80%). Në këtë nivel

duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematike me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

### **Procedura e vlerësimit**

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Është e kuptueshme se vlerësimi duhet të ndjekë qëllimet arsimore, objektivat mësimore, objektivat e vlerësimit. Vlerësimi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash në të cilat duhet të përfshihen këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i ndihmesës gjatë punës në grup;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë
- testet për një grup temash të caktuara;
- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
- testet në fund të gjysëmvetorit;
- testet në fund të vitit etj.

Në fund të vitit duhet të nxirret nota përfundimtare, e cila fitohet duke nxjerrë mesataren e vlerësimeve:

- Vlerësimi me gojë 25%
- Testet 50%
- Vlerësimi i punës në klasë 15%
- Vlerësimi i detyrave të shtëpisë 10%

### **LIDHJET NDËRLËNDORE**

Matematika në klasën e tretë ndërlidhet me:

- **Gjuhën amtare** - “përkthimi” i shprehjeve matematike nga gjuha e zakonshme në gjuhën matematike dhe anasjelltas;

- **Artet e bukura** - vizatimi i vijave të drejta të lakuara, të hapura, të mbyllura dhe figurave të ndryshme gjeometrike;
- **Edukatën fizike dhe sportet** - orientimi në hapësirë (lëvizjet majtas, djathtas, para, pas; kërcimet lart, larg etj.; matjet e ndryshme;
- **Punëdore** - ndërtimi i figurave dhe i trupave të ndryshëm gjeometrikë nga kartoni, plastelina argjila etj.

**Vërejtje.** Nga programi ekzistues i kl. III nuk janë përfshirë këto njësi:

1. Numrat natyrorë deri 10000 (përcillet në kl. IV);
2. Nga njësitë matëse për gjatësinë largohet kilometri (sepse nuk janë mësuar numrat më të mëdhenj se 1000);
3. Modelet (rrjetet) e trupave gjeometrikë (përcillet në kl. V dhe VI);
4. Pozita reciproke e drejtëzave (në rrafsh) (përcillet në kl. IV);
5. Kuptimi i syprinës dhe i vëllimit (përcillet në kl. V);
6. Thyesat më të mëdha se një; krahasimi i thyesave (përcillet në kl. IV dhe V).

**Merret si njësi e re:**

1. Përpunimi i të dhënave.
2. Bëhet dallimi ndërmjet shumëkëndëshave (si vija) dhe sipërfaqeve të shumëkëndëshave përkatës (si figura gjeometrike në rrafsh).

**LITERATURA E PREFERUAR**

Tekste shkollore që përdoren në arsim joformal

## **NJERIU DHE NATYRA**

1 orë në javë, 36 orë në vit

### **HYRJE**

Lënda **Njeriu dhe natyra** fillon të mësohet në klasën e 3 (tretë), si lëndë e integruar e shkencave të: biologjisë, kimisë, fizikës, dhe gjeografisë. Nxënësit njihen me natyrën që na rrethon, të mirat materiale për jetë, trupat, pozitën dhe rolin e njeriut në mesin e tyre, nevojat e vazhdueshme të njeriut për burime të reja të energjisë dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

### **QËLLIMET**

Programi i lëndës **Njeriu dhe natyra** në klasën e tretë ka për qëllim:

- të zhvillojë aftësi të nxënësit për të njohur natyrën, objektet e saj, mjedisin jetësor dhe ruajtjen e tij.
- të kultivojë nxënësi shprehi dhe të fitojë shkathtësi për vrojtme, matje, arritje në përfundime të sakta të ligjshmërive natyrore, ndërlydhje të tyre dhe punë të pavarur në zgjidhjen e problemeve konkrete;
- të formohet nxënësi personalitet stabil dhe vetëkritik, i qëndrueshëm dhe i gatshëm për bashkëpunim me mësimdhënës në shkollë dhe jashtë saj dhe i aftë në ballafaqim me sfidat e jetës.

### **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË**

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

#### **Të njohë:**

- trupat, përmasat dhe pozitën e tyre;

- përbërjen e trupave (lëndët e pastra dhe të përziera) dhe shndërrimet e tyre;
- vetitë, lëvizjet e trupave (lëndëve, objekteve);
- proceset jetësore, ndërtimin dhe marrëdhëniet e qenieve të gjalla me mjedisin.

#### **Të kuptojë:**

- bashkëveprimin mes trupave (mekanikë dhe magnetikë);
- ndërveprimin e qenieve të gjalla dhe të mjedisit;
- ditë-natën dhe stinët e vitit si rrjedhojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit dhe rreth Diellit;
- rolin e ushqimit dhe të higjienës në shëndetin e njeriut;
- shndërrimet e lëndës dhe të energjisë.

#### **Të zbatojë:**

- përdorimin e lëndëve ushqyese, higjienike dhe shëndetësore në jetën e përditshme;
- termometrin për matje të temperaturës;
- ilustrime, harta dhe fotografi;
- njohuritë e fituara për ruajtjen e mjedisit jetësor.

#### **Të analizojë:**

- përbërjen e lëndëve të ndryshme;
- burimet e energjisë.

#### **Të sintetizojë:**

- të kombinojë dy e më shumë lëndë për të përftuar lëndë të reja e me veti të ndryshme.

#### **Të vlerësojë:**

- rëndësinë e natyrës në jetën dhe në veprimtarinë e njeriut;
- rolin e njeriut në ruajtjen e mjedisit jetësor.



**ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE****1 orë në javë, 18 javë në vit**

<b>Kategoritë</b>	<b>Nënkategoritë</b>	<b>Numri i orëve</b>	<b>%</b>
I. Qeniet e gjalla dhe proceset jetësore	1. Karakteristikat e qenieve të gjalla. 2. Bimët dhe kafshët 3. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	7	38.88
II. Lënda dhe energjia	1. Lënda dhe vetitë e saj 2. Shndërrimet e lëndës	4	22.28
III. Proceset fizike	1. Forca dhe lëvizja 2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita	4	22.28
IV. Toka dhe gjithësia	1. Toka, Dielli, Hëna dhe planetët	3	16.66
<b>Tërësisht</b>		<b>18</b>	<b>100</b>



	<p><b>I.3. Qeniet e gjalla dhe mjedisi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjatë jetës së tyre njeriu, bimët dhe shtazët pësojnë ndryshime të rregullta në formë të ciklit jetësor.</li> <li>• Në pyll jetojnë së bashku lloje të ndryshme të bimëve dhe shtazëve të varura mes vete dhe nga kushtet fizike të pyllit.</li> <li>• Njeriu sëmundet nga sëmundje të ndryshme, shkaktarë të të cilave janë gjallesat shumë të imëta të cilat nuk shihen me sy-mikrobet.</li> </ul>	<p>dhe të flutures.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të identifikojë dhe të përshkruajë ndryshimet në bimë prej lules deri në frut.</li> <li>- Të dallojë komponentet e gjalla dhe jo të gjalla të një mjedisi jetësor, siç është pylli.</li> <li>- Të emërtojë bimët dhe shtazët karakteristike të pyllit.</li> <li>- Të përshkruajë se bimët në pyll prodhojnë ushqimin për vete dhe për të gjithë organizmat e tjerë, se disa shtazë ushqehen vetëm me bimë, të tjerat vetëm me shtazë, kurse disa të tjera edhe me bimë edhe me shtazë</li> <li>- Të përshkruajë se sëmundjet e ndryshme të njeriut shkaktohen nga gjallesat e imëta të cilat nuk shihen me sy (mikrobe) dhe se këto barten përmes njerzëve, shtazëve, ujit dhe ushqimit të papastër.</li> <li>- Të tregojë se disa sëmundje ngjithëse fitohen vetëm një herë gjatë jetës, kurse parandalimi i tyre bëhet përmes vaksinimit.</li> </ul>	
--	--	---	---	--

<p><b>II. Lënda dhe energjia</b></p>	<p><b>II.1 Lënda dhe vetitë e saj</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Lënda, klasifikimi dhe toka si burim i të mirave materiale për jetë</b> (Lëndët ose artikujt e përditshëm me të cilët jeton dhe punon nxënësi, toka burim i të gjitha të mirave materiale jetësore)</li> <li>• <b>Uji dhe ajri</b> (Përhapja në natyrë vetitë dhe përdorimi i ujit dhe i ajrit, funksioni i tyre për jetë)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi do të jetë në gjendje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet lëndëve, me anë të shqisave.</li> <li>- Të emërtojë llojet e ndryshme të lëndëve, siç janë: uji, qelqi, druri, metali, plastmasat, letra, sheqeri, vaji etj.</li> <li>- Të tregojë lëndët që nxirren nga toka, siç janë: ushqimet, lëndët e djegshme, mineralet, druri, shkëmbinjë, uji etj., që përdoren në jetën e përditshme.</li> <li>- Të përshkruajë ujin si lëndë e domosdoshme në natyrë, në teknologji dhe në jetë</li> <li>- Të shpjegojë vetitë e ujit, qarkullimin në natyrë (avullimi, kondensimi, ngrirja, të reshurat),</li> <li>- Të përcaktojë temperaturën e lëndëve të ndryshme me termometër.</li> <li>- Të vlerësojë rolin dhe qëndrimin e njeriut për ruajtjen e ujit dhe të mjedisit nga ndotësit.</li> <li>- Të përshkruajë ajrin si lëndë e gaztë që na rrethon dhe që nuk e shohim, por në forma të ndryshme</li> </ul>	<p>Punëdore (punimi i modeleve nga letra dhe kartoni, lëndët ushqyese, rreziqet nga lëndë të ndryshme, zjarri, rryma elektrike, ndotja e ambientit etj.).          Arti figurativ (dallimi ngjyrave, modeleve i etj.)          Mjekësia dhe shëndetësia (mirëmbajtja e higjienës personale, mënyra e përdorimit, e ruajtjes, afati i skadencës së barnave etj.).</p>
--------------------------------------	---	---	---	--

			<p>e hetojmë praninë e tij (procesi i frymarrjes, procesi i djegies, kundërmimi, lëvizja e erës etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të vlerësojë rëndësinë e ajrit për jetë (procesin e frymarrjes, procesin e djegies, procesin e zhvillimit të bimëve dhe në industri).</li> </ul>	
<b>II. Lënda dhe energjia</b>	<b>II. 2. Shndërrimet e lëndëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Lëndët ushqyese, higjienike dhe burimet e energjisë</b> (Lëndët ose artikujt e përditshëm ushqimorë dhe higjienikë, burimet kryesore të energjisë dhe përdorimi i tyre)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi do të jetë në gjendje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë lëndët kryesore të ushqimit (buka, drithërat, mishi, peshku, prodhimet e qumështit, sheqeri, mjalti, gjalpa, vaji, pemët, perimet vitaminat dhe kripa e gjellës).</li> <li>- Të dallojë lëndët ushqyese me prejardhje bimore dhe shtazore.</li> <li>- Të identifikojë lëndët ushqimore natyrore dhe ato të përpunuara (artificiale).</li> <li>- Të arsyetojë rëndësinë e lëndëve higjienike për ruajtjen e shëndetit.</li> <li>- Të vlerësojë ndikimin e dëmshëm të lëndëve helmuese (acidet, mjetet për zbardhje dhe dezinfektim “varikinet”, detergjentet, pesticidet), të djegshme (alkoolet, nafta, benzina, gazi propan- butan) dhe pëlcitëse (fishekzjarret).</li> </ul>	

			<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shfrytëzojnë recetat për përdorimin e lëndëve higjienike, të cilat janë të shënuara në paketim të tyre.</li> <li>- Të përshkruajnë burimet kryesore të energjisë, duke filluar nga ushqimi (për organizëm), diellore, lëndët e djegshme, qymyri, nafta, gazi natyror, druri, uji, era, etj., dhe rëndësia e tyre për jetë,</li> <li>- Të përgatisin çaj, kafe, pije freskuese, akullore etj.</li> </ul>	
<b>III. Proceset fizike</b>	<b>III.1. Forca dhe lëvizja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trupat në natyrë dallohen sipas vetive të ndryshme (ngjyrë, formë, peshë, madhësi, temperaturë dhe përbërje).</li> <li>• Trupat vendosen në baraspeshim në mënyra të ndryshme (kandari, peshorja, luhatja në traverzë).</li> <li>• Makinat e thjeshta shërbejnë për të kryer pune më lehtë.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë trupat sipas ngjyrës, formës, përbërjes (të ngurtë, të lëngët, të gaztë, elastik), sipas peshës, madhësisë (vëllimi) dhe temperaturës.</li> <li>- Të tregojë shembuj të baraspeshimit të trupave, duke u bazuar në lojërat e përditshme në shkollë dhe në shtëpi.</li> <li>- Të identifikojë gjashtë lloje të makinave të thjeshta: llozin, vidën, çikrikun, rrotën dhe boshtin, rrafshin e pjerrët dhe pykën dhe të gjejë shembuj të makinave të thjeshta që mund t'i gjejë në shkollë dhe në shtëpi.</li> </ul>	<p>Arti figurativ për vizatime të ndryshme, vizatimin e makinave të thjeshta dhe për njohjen e ngjyrave.</p> <p>Punëdore për njohje të formës, madhësisë, peshës dhe vëllimit të trupave, për demonstrimin e baraspeshimit të trupave dhe ndërtimin e makinave të thjeshta.</p>

<b>III. Proceset fizike</b>	<b>III.2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Magnetët veprojnë në mes veti me pole të veta pa u takuar fare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të demonstrojë tërheqjen dhe shtyrjen e poleve të njëjta magnetike pa u takuar fare dhe të gjejë shembuj të bashkëveprimit dhe të zbatimit të magnetëve në jetën e përditshme.</li> </ul>	Punëdore, për ndërtimin e mbajtëseve në të cilat duhet të varen magnetët me fije najloni me qëllim të demonstrimit të veprimit në mes tyre.
<b>IV. Toka dhe hapësira</b>	<b>IV.1 Rrethina ime</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Orientimi</b> në natyrë (skica, harta, globi)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë anët kryesore të botës (veri, jug, lindje dhe perëndim)</li> <li>- Të tregojë se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe tërë Toka mund të paraqitën në letër, glob të zvogluara dhe me shenja të veçanta</li> </ul>	
<b>IV. Toka dhe hapësira</b>	<b>IV.2. Toka, sistemi diellor dhe gjithësia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dita, nata dhe stinët e vitit</b></li> <li>• <b>Kosova – Vendi im</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të tregojë se Dielli është burim i dritës, i nxehtësisë dhe i jetës në Tokë,</li> <li>- Të përshkruajë arsyet e ndërrimeve të ditë-natës, stinëve të vitit dhe ndryshimet e motit.</li> <li>- Të tregojë pozitën e Kosovës në hartë dhe fqinjët e saj.</li> <li>- Të përshkruajë veçoritë elementare natyrore (relievin, ujin, ndryshimet e motit, botën bimore dhe shtazore) në Kosovë.</li> </ul>	

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe të programit të lëndës Njeriu dhe natyra, është e domosdoshme të zbatohen metoda , teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks i tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike, siç janë: vizatime, peizazhe, diagrame, modele, grafikone, kimikate, enë kuzhine, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore – kompjuter, internet etj.).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxësin dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimitnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera participojnë në tërësinë e formimit të personalitetit për t'u përballur me sfidat jetësore..

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegimi, sqarimi, ushtrimet praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënës në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit ( të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënës përmes mjeteve multimediale, në veçanti përmes kompjuterit;



- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat e objekteve industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatese didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të matur punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi, stafi arsimor, shkolla dhe komuniteti i saj. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto forma të vlerësimit:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo temë mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve (përgjigjet me gojë, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe të punimeve me shkrim etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për tërësi temash, për një gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione për përparimin e nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësues;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojë përparimin e nxënësve
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojë për përmirësimin e mësimit bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

## **BURIMET DHE MJETET MËSIMORE**

Që të realizohet me sukses mësimit dhe mësuesit e planit dhe e programit të njeriut dhe të natyrës, mësimit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme të informimit:

- 1) Literaturë për lëndën Njeriu dhe natyra në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja botërore.
- 2) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 3) Fotografji, atlase, modele, skema, diagrame, makete, harta, glob etj.
- 4) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 5) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 6) Literaturë tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjete të tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjete ndihmëse mësuese, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësimit.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësuese duhet t'i takojë edhe nxënësit.

## **EDUKATA QYTETARE**

### **HYRJE**

Edukata qytetare në klasën e tretë mësohet me nga një orë për 18 javë. Ajo u ndihmon nxënësve të vetëdijsohen për identitetin dhe sigurinë e tyre personale, të mësojnë të komunikojnë, të respektojnë besimet dhe vlerat kulturore në një shoqëri shumë etnike, të kuptojnë mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve në familje, në shkollë dhe në komunitet, si dhe të njihen me natyrën e funksionimit të demokracisë.

### **QËLLIMET**

Qëllimet e edukatës qytetare janë në harmoni me qëllimet e përgjithshme të arsimit të detyruar, e që kanë të bëjnë me zhvillimin personal, social dhe moral të nxënësve, përkatësisht për t'i bërë ata qytetarë të përgjegjshëm. Në këtë këndvështrim, lënda edukatë qytetare synon:

- Të krijojë kushte që nxënësi të përfitojë njohuri të nevojshme për demokracinë dhe qytetarinë;
- Të mundësojë krijimin e qëndrimeve, të vlerave dhe të sjelljeve si dhe pranimin kritik të informacionit dhe të mjeteve të komunikimit;
- T'i zhvillojë të nxënësit njohuritë dhe t'i zhvillojë aftësitë e tij intelektuale dhe qytetare, për të kuptuar, analizuar dhe vepruar në jetën e përditshme qytetare;
- Të krijojë qytetarë të aftë, të jenë të përgjegjshëm për veprime dhe marrëdhënie të pavarura me qytetarë të tjerë, me grupe dhe institucione të shoqërisë civile.

## **OBJEKTIVAT**

Nxënësi:

### **Të njohë**

- tiparet e tij kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët;
- tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai jeton;
- rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë, shkollë etj.;
- mjetet kryesore të komunikimit: telefon, letër, telegram, internet.

### **Të kuptojë**

- ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me anëtarët e familjes, me shokët etj.;
- rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar;
- rëndësinë e informimit dhe të komunikimit në forma të ndryshme.

### **Të vlerësojë**

- të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të familjes;
- rolin e tij dhe të të tjerëve në familje, grup dhe komunitet;
- nevojën që ai ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;
- kulturën, vlerat dhe besimet në një shoqëri shumë etnike.

### **Të zbatojë**

- në situata të simuluar, sjellje të sigurt në komunikacion;
- të përdorë fjalorin e duhur në një situatë të caktuar në rrugë;
- gatishmërinë e tij për të ndjekur rregullat në veprimtaritë e përditshme në familje, grup, shkollë dhe komunitet.

### **Të analizojë**

- ndarjen e detyrave në familjen e tij.;
- rregulla të thjeshta në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme.

### **Të sintetizojë**

- aspekte të ndryshme të jetës në familjen e tij me atë të familjeve të tjera (ushqimi, orëditë, organizimi i kohës së lirë);

- rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë.

### **Të zhvillojë qëndrime dhe vlera**

- se diversiteti kulturor, fetar dhe gjuhësor është begati e një shoqërie demokratike;
- të shfaqë qëndrim kritik ndaj mënyrës së komunikimit me të tjerët në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.

## **STRUKTURA E PROGRAMIT**

**(18 X 1 = 18 )**

Kategoria: ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI  
**(Identiteti, rritja dhe ndryshimi. Siguria dhe mbrojtja) 5 orë**

Nxënësi të përvetësojë përmbajtjen e koncepteve themelore për identitetin personal, nevojat, dëshirat, besimin, vetëbesimin etj., si dhe të koncepteve: siguri, siguri personale, mbrojtje, mbrojtje personale, mbrojtje nga uji, zjarri, rryma elektrike etj.

### **Rezultatet e pritshme**

Nxënësi:

- ✓ të radhisë disa nga tiparet që e karakterizojnë atë si njeri;
- ✓ të përshkruajë nevojat dhe dëshirat e tij;
- ✓ të këtë besim në vetvete për marrjen e vendimeve;
- ✓ të shpjegojë ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me shokët, me anëtarët e familjes (gjyshërit, prindërit, vëllezërit, motrat etj.);
- ✓ të kuptojë se plotësimi i nevojave, si: ushqimi, veshja, banesa, mësimi etj., përbën një të drejtë elementare që i takon si atij, edhe të tjerëve;
- ✓ të identifikojë disa nga rregullat e sjelljes së tij në: shtëpi, në rrugë, në park, në lagje etj.;
- ✓ të dijë dhe të respektojë rregullat e përdorimit të ujit, zjarrit, rrymës elektrike në shtëpi, në shkollë dhe gjetiu.

Kategoria: GRUPET DHE INSTITUCIONET  
**(Familja – shkolla) 6 orë**

Nxënësi duhet të përvetësojë përmbajtjen e koncepteve bazë si: familje, shkollë, shtëpi-banesë; të kuptojë rolin, detyrat, të drejtat dhe obligimet e familjes dhe shkollës; ndarjen e punëve në familje, rregullat në familje, festat familjare etj

**Rezultatet e pritshme:**

Nxënësi:

- ✓ të vlerësojë të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të familjes;
- ✓ të përshkruajë disa nga festat familjare, festat lokale dhe kombëtare;
- ✓ të bashkëveprojë me të tjerët në familje, klasë, grup, lagje etj., për të zgjidhur probleme të ndryshme;
- ✓ të demonstrojë vullnet për respektimin e rendit shtëpiak në shkollë;
- ✓ të përshkruajë shembuj nga jeta shkollore si është e hapur shkolla për të gjithë që e dëshirojnë atë.

Kategoria: KULTURA  
**(Gjuha dhe komunikimi, Vlerat kulturore dhe besimet) 4 orë**

Nxënësi të përvetësojë përmbajtje programore lidhur me gjuhën, komunikimin, format dhe mjetet e komunikimit, Të zotërojë konceptet themelore për vlerat kulturore dhe besimet, diversitetet etnike, gjuhësore, fetare dhe gjinore si begati e shoqërisë.

**Rezultatet e pritshme**

Nxënësi:

- ✓ të përshkruajë mjetet kryesore të komunikimit: telefon, letër, telegram, internet;
- ✓ të vlerësojë marrjen e informacionit për ngjarje të ndryshme nga radio, televizioni, kompjuterin (internetin) dhe gazetat;

- ✓ të shprehë gatishmërinë për t'i ndihmuar ata që kanë vështirësi për të komunikuar;
- ✓ të dëshmojë praktikisht rëndësinë e tolerancës, të dashurisë dhe të mirëkuptimit ndërmjet njerëzve;
- ✓ të organizojë vetë festat e tyre, duke dhënë kontribut vetjak në punën e përbashkët në festa.

**Kategoria: KOHA DHE NDRYSHIME  
(Koha dhe njeriu)-3 orë**

Në nënkategorinë Koha dhe njeriu nxënësi duhet të zotërojë konceptet themelore si: zhvillimi, ndryshimet, koha: e kaluara, e sotmja dhe ardhmja; burimet natyrore etj.

**Rezultatet e pritshme**

Nxënësi:

- ✓ të japë shembuj që tregojnë për mënyrën e ndryshimit të jetesës në komunitet;
- ✓ të përdorë burime të ndryshme për të kuptuar dhe rindërtuar të kaluarën, si letra, ditare, intervista, libra, fotografi etj.;
- ✓ të përshkruajë sesi njerëzit kanë krijuar vendet e tyre të banimit dhe si e kanë ndryshuar jetën e tyre;

**LIDHJE NDËRLËNDORE**

Edukata qytetare gërshetohet me programet dhe përmbajtjet e lëndëve të tjera shoqërore si histori dhe gjeografi, gjuhë dhe komunikim, por dhe me matematikën, fizikën, artet, edukimin fizik etj.

**Gjuha dhe komunikimi:** Esetë dhe shkrimet për temat e qytetarisë, p.sh., “Kush jam unë?”, apo dhe përdorimi i gazetave, i revistave, i pjesëve letrare dhe i shkrimeve të tjera, që trajtojnë ngjarje dhe episode nga jeta e përditshme, janë urë lidhëse e trajtimit të temave të qytetarisë me fushën e gjuhës dhe të komunikimit.

**Artet:** Përgatitja e materialeve ilustruese, si postera, albume, si dhe efekte të tjera vizuale për një vetëdijësim qytetar demokratik. Kjo

ndërlidhje mund të përdoret në tema: si nevojat dhe të drejtat e njeriut, rregullat në klasë, në shtëpi dhe në komunitet. Edukimi artistik nëpërmjet këngëve, valleve popullore dhe atyre të huaja, po ashtu rrit peshën e ndërveprimit të edukatës qytetare me muzikën.

**Matematikë:** Përdorimi i numrave lidhur me tema aktuale të edukatës qytetare, interpretimi i të dhënave që lidhen me zgjidhjen e problemeve sociale brenda grupit, krijojnë, po ashtu, mundësi për qasje ndërlëndore në mësim.

## UDHËZIME METODIKE

Për realizimin e suksesshëm të programit mësimor të edukatës qytetare mund të shfrytëzohen burime të ndryshme dhe të simulohen raste për zgjidhje, p.sh:

- Takime me njerëz të ndryshëm të komunitetit (vëzhgime, intervista, anketime, bashkëbisedime, konsulta me ekspertë etj.);
- Përdorimi i publikimeve të ndryshme (gazeta, buletine informacioni, tekste, videokaseta, dramatizime, postera etj.);
- Simulime (simulimi i diskutimeve ose i situatave nga fusha të ndryshme të veprimtarive publike etj.).

Rëndësi e veçantë duhet t'u kushtohet metodave aktive të punës, si: puna me projekte, mësimi problemor, mësimi me bashkëpunim, biseda etj.

Si forma të punës, mësimdhënësve u sugjerohet të organizojnë punën në klasë me çifte dhe grupe. Ndarja e nxënësve në çifte dhe grupe u jep atyre mundësi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Me këtë rast nxënësve të ndarë në çifte dhe grupe u jepet 5 minuta kohë për të vendosur. Kjo mund të arrihet përpara se të nisë diskutimi i tërë klasës. Nxënësve duhet t'u tregohet koha për të cilën do të zgjidhet problemi. Ata ndahen në grupe apo çifte, ndërsa mësuesi luan rolin e mbikëqyrësit dhe, sipas nevojës jep udhëzime apo sqarime. Në përfundim të orës mësimore, çiftet apo grupet raportojnë para nxënësve të klasës. Secili grup duhet ta këtë përfaqësuesin i cili raporton para klasës.



## **UDHËZIME PËR VLERËSIM**

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e edukatës qytetare duhet të jetë i përhershëm. Ky vlerësim ka qëllime të shumëfishta. Kështu, përmes vlerësimit:

- sigurohen informacione për përparimin e nxënësit;
- nxënësit aftësohen të krahasojnë arritjet e tyre me rezultatet e pritshme. Në këtë mënyrë nxënësi do të bëjë edhe vetëvlerësimin e asaj që ka arritur të zotërojë.
- sigurohet motivimi i nxënësve për punë të mëtejshme.
- sigurohet edhe realizimi i objektivave.

### **Llojet e vlerësimit**

Në lëndën e edukatës qytetare mund të aplikohen disa lloje të vlerësimit. Secili prej tyre, ka qëllime të caktuara.

Vlerësimi duhet të jetë i përhershëm, duke filluar nga orët e mësimit, veprimtaritë praktike e deri te vlerësimi përmes testeve zyrtare. Në klasë, gjatë orës së mësimit, mund të bëhen këto vlerësime:

- vlerësimi i zakonshëm gjatë pjesëve të ndryshme të orës
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë
- vlerësimi i projekteve të realizuara individualisht ose në grup
- vlerësimi me teste të hartuara nga vetë mësuesi.

Kriteret për vlerësimin e nxënësve janë përcaktuar qartë në Udhëzimin administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve.

## **LITERATURA**

1. Tekste shkollore që përdoren në arsimin joformal
2. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, UNICEF, Prishtinë, 2000

3. Rozemberg. M. “Një model i komunikimit jo të dhunëshëm, Prishtinë ,1996
4. Demokracia për të gjithë (doracak për mësimëdënës) edukimi për një kulturë demokratike&Kinderbeg, International, 2003, Prishtinë
5. Instituti i Studimeve Pedagogjike , Standardet për nxënësit dhe mësuesit në lëndën e edukimit qytetar, (DRAFT), Tiranë, 1997
6. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimëdhënies, Tiranë, 2003
7. Instituti i Studimeve Pedagogjike, Platforma e hartimit të standardeve të arritjes për lëndët, Tiranë, 2002
8. Grup autorësh, Strategji për të mësuarit e qytetarisë demokratike, Tiranë, 2000
9. Librat e mësuesit për edukimin qytetar, kl-1-10;
10. Standardet e edukimit qytetar –1-10, Tiranë 2003

## EDUKATË FIGURATIVE

(1 orë në javë, 18 orë në vit)

### HYRJE

**Edukata figurative** u mundëson nxënësve mënyrën më të saktë të përceptimit, të përshkrimit dhe të krijimit të trajtave natyrore dhe të krijuara nga njeriu. Gjithashtu, kjo lëndë rrit aftësinë e njohurive të përgjithshme dhe mundëson mësimin më funksional të të gjitha segmenteve jetësore. Mësimi dhe ngritja figurative për nxënësit e klasës së tretë zhvillohet në bazë të imagjinatës kreative në kompleksivitetin e tërsisë hapësinore.

- Modifikimi i procesit mësimor figurativ tani arrihet përmes njohurive dhe përvojave të fituara më parë, në shoqërorizim të krijimeve personale dhe aftësive gjyquese për kategoritë e veçanta hapësinore.
- Edukata figurative nxënësve të këtij niveli u jep mundësi aktive për punë praktike dhe stimulim argëtues në arritjen e dëshirave të synuara dhe përballimin e vështirësive shoqërorizuese.

### QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së edukatës figurative për klasën e tretë në arsimimin joformal ka për qëllim:

- Avancimin dhe zgjerimin e njohurive figurative për krijimet dhe fenomenet hapësinore si dhe përdorimin dhe emërtimin e ngjyrave primare (bazike) e sekondare (të përfituara) në punime.
- Fitimin e njohurive dhe të përvojave më praktike për realizimin e detyrave të shtruara dhe zhvillimin e shkathtësive kreative, për arritjen e rezultateve të dëshiruara në punën krijuese dhe përdorimin e materialit dhe të mjeteve realizuese.

## OBJEKTIVAT

E përgjithshëm	Specifikë
<i>Nga përmbajtja programore e klasës së tretë, nxënësi do të jetë në gjendje:</i>	
➤ Të vështrojë e të analizojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirën në këndin pamor: format, ngjyrat, strukturat përbërëse.</li> <li>• Modelet e zgjedhura për krijim.</li> </ul>
➤ Të njohë e të zotërojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvojat e mësuara më parë.</li> <li>• Emërtimin e ndonjë drejtimi figurativ.</li> <li>• Materialet dhe mjetet për krijim.</li> </ul>
➤ Të veçojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Momentet më impresive nga pamjet dhe dukuritë.</li> </ul>
➤ Të dallojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet, madhësitë dhe përbërjet e objekteve.</li> </ul>
➤ Të krijojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punime sipas afinitetit personal.</li> <li>• Raporte komunikuese me rrethin.</li> </ul>
➤ Të komunikojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Me shenja vizuale dhe art të aplikuar.</li> </ul>

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë
<b>I. Të vërejturit dhe njohuritë</b>	1. Relacionet në hapësirë.....( 2 orë ) 2. Raporti i formave.....( 2 orë ) 3. Përfshirjet sipërfaqësore.....( 2 orë )
<b>II. Të shprehurit dhe kreativiteti</b>	1. Vija.....( 3 orë ) 2. Ngjyra .....( 3 orë ) 3. Harmonia dhe kontrasti.....( 1 orë )
<b>III. Analiza dhe vlerësimi</b>	1. Degëzimi i artit.....( 2 orë ) 2. Komunikimi.....( 2 orë ) <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Orë të zgjedhura .....( 1 orë )</li> </ul>

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

### I. Të vërejturit dhe njohuritë

- Udhëzim: Aftësimi i nxënësve për vërtetim hapësinor, në formë dhe përbërje sipërfaqësore të objekteve si dhe njohja thelbësore e doktrinëve artistike gjatë shtjellitimit të punëve kreative

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Relacionet në hapësirë</b> (2 orë)</li> </ul>	<p>Njoftimi dhe zgjedhja e temave nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Planet hapësinore;</b> më afër, në mes dhe më larg; (Shpjegimi dhe puna praktike me nxënës, kur objektet e ndodhura më afër dallohen si më të mëdha).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje - 2 orë (lapsi i butë, ngjyrat e drurit, flomastera, ngjyrat e ujit etj.)</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillojnë aftësinë për dallim të relacioneve hapësinore në fushën e tyre pamore;</li> <li>• Vizatojnë dhe ngjyrosin punimet në mënyrë të lirë nga temat hapësinore;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Raporti i formave</b> (2 orë)</li> </ul>	<p>Njoftimi dhe zgjedhja e temave nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Madhësitë e formave:</b> të mëdha, të vogla.</li> <li>❖ <b>Ngjyrat e formave:</b> (Format më të afërta, ngjyrat më intensive dhe anasjelltas).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje - 1orë (lapsi i butë, ngjyrat e drurit, flomastera, ngjyrat e ujit etj.)</i></li> <li>○ <i>Modelim -1 orë (plastelinë, letër me ngjyra, tekstil etj.)</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bëjnë dallimin dhe krahasimin e madhësive dhe të ngjyrave në raport me format e ndryshme.</li> <li>• Shprehen me punime të formave dhe ngjyrave përkatëse.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfshirjet sipërfaqësore</b></li> </ul>	<p>Krahasimi i sipërfaqeve të ndryshme dhe puna praktike në</p>		<p>Nxënësit do të:</p>

(2 orë)	bazë të: ❖ <b>Tonalitetit të ngjyrave:</b> në një sipërfaqe të caktuar ngjyra mund të jetë e plotë (100%), gjysmeplotë (50%) dhe e intensitetit më të ulët 20%). ❖ <b>Strukturave sipërfaqësore:</b> të objekteve në natyrë: (të lëmuara dhe të vrazhdta).	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje- 1 orë, (lapsi i butë, ngjyrat e drurit, flomastera, ngjyrat e ujit etj.).</i></li> <li>○ <i>Kolazh – 1, orë ngjitja e letrave shkëlqyese, fijet e shkrepës, kokrra orizi ose fasule etj.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallojnë dhe do të punojnë sipërfaqet me tonalitete të ngjyrave të ndryshme.</li> <li>• Pikturojnë e kolazhojnë një punim tematik.</li> </ul>
---------	--	--	--

## II. Të shprehurit dhe kreativiteti

- Udhëzim: Të shprehurit dhe kreativiteti të nxënësit të kësaj moshe pasqyrohet përmes punës kreative nga motivet e zgjedhura për krijim dhe përvoja kreative e fituar më parë në përfitimin e shkathtësive të reja gjatë përdorimit të vijave, ngjyrave dhe efekteve të tjera realizuese.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vija</b> (3 orë)</li> </ul>	Përcaktimi i temave të zgjedhura në bazë të modeleve për vizatim: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Peizazh;</b></li> <li>• <b>Natyrë e qetë;</b></li> <li>• <b>Portret;</b></li> <li>• <b>Formë e aplikuar.</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim 2 orë (lapsi i butë, ngjyrat e drurit, flomastera, ngjyrat e ujit etj.)</i></li> <li>○ <i>Modelim-1 orë (plastelinë, shkopinj, tel i butë etj.)</i></li> </ul>	Nxënësit do të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallojnë llojet e vijave.</li> <li>• Vizatojnë peizazh, natyrë të qetë ose portret nga modeli i zgjedhur.</li> <li>• Shprehen me vija, me ngjyra e me mjete të tjera krijuese.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ngjyra</b> (3 orë)</li> </ul>	<p>Njohja dhe përshtatja e temave për punë praktike me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Ngjyrave primare - bazë</b> (e verdha, e kuqja dhe e kaltra).</li> <li>❖ <b>Ngjyrave sekondare - të përfituara</b> (nga kombinimi i ngjyrave bazike).</li> <li>❖ <b>Ngjyrave neutrale</b> (e bardha, e përhimta dhe e zeza).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje - 2 orë (lapsi i butë, ngjyrat e drurit, flomastera, ngjyrat e ujit, ngjyrat pasteve etj.)</i></li> <li>○ <i>Modelim-1 orë (plastelinë, shkopinj, gurë të vegjël, letër me ngjyra etj.)</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të dinë dallimin e ngjyrave.</li> <li>• Përfitojnë shkathtësi krijuese me ngjyra edhe në materiale të tjera.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Harmonia dhe kontrasti</b> (1 orë)</li> </ul>	<p>Ushtrime praktike për realizimin e një kollazhi të thjeshtë tematik në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Materialeve me ngjyra;</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Kolazh (përdorimi i letrave, i tekstileve apo i materialeve të tjera me ngjyra) - 1 orë.</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehen me shembuj kreativë gjatë ngjitjes së letrave ose materialeve të tjera me ngjyra.</li> </ul>

### III. Analiza dhe vlerësimi

- Udhëzim: Kjo kategori parashtron përfitimin e njohurive të para për degëzimin e artit vizuel në përgjithësi dhe rrit aftësinë e komunikimit masiv në relacione të ndryshme kohore e pamore.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Degëzimi i artit</b> (2 orë)</li> </ul>	<p>Njohja me ndarjet e artit pamor në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Artin figurativ:</b> vizatimi, piktura, skulptura, grafika.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Mësim teorik për ndarjen e artit - 1 orë.</i></li> <li>○ <i>Demonstrim konkret me</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregojnë ndarjen e artit dhe së paku nga dy drejtime të fushave</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Artin e aplikuar:</b> dizajni, qeramika, tekstili etj.</li> </ul>	<p><i>shembuj nga fusha e artit figurativ e aplikativ -1 orë (demonstrim me punime, fotografi, fotoslajde, internet etj.).</i></p>	përkatëse.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Komunikimi</b> (2 orë)</li> </ul>	<p>Njohja dhe komunikimi në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Shenjave dhe simboleve</b> (shenjave në rrugë dhe mjete të tjera komunikuese si në: libra, revista, postera, simbole etj.)</li> <li>❖ <b>Pamjeve të lëvizshme</b> (reklammat televizive, filmat e vizatuar etj.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Rikrijimi i shenjave, simboleve sipas zgjedhjes së lirë – 1 orë (laps ose ngjyrat e zgjedhura).</i></li> <li>○ <i>Punime të shenjave e simboleve - 1 orë (plastelinë, tel i butë, shkopinj, letra të ndryshme etj.).</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunikojnë dhe do të shprehin imagjinatën e tyre kreative në bazë të formulimit të shenjave dhe simboleve.</li> <li>• Njohin shenjat e komunikimit dhe porosinë e tyre.</li> </ul>



## **QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE**

- Edukata figurative ka qasje ndërlëndore e programore me të gjitha lëndët e tjera mësimore. Përshkrimet ilustrative në tekste dhe në mjete të tjera mësimore u ndihmojnë nxënësve që më lehtë t'i kuptojnë njësitet mësimore, por gjithashtu thurjet tekstuale e ndihmojnë zhvillimin e imagjinatës së nxënësve edhe në fusha të tjera.
- Kjo lëndë ka qasje ndërlëndore e programore me gjuhën shqipe, matematikën, punëdoren, muzikën, edukatën qytetare, edukatën fizike, por, gjithashtu, edhe me historinë, gjeografinë, biologjinë, fizikën e lëndë të tjera nga nivelet më të larta.
- Edukata figurative është lëndë gjithpërfshirëse dhe përmes saj të kuptuarit logjik mund të zbatohet në procesin mësimor joformal, duke zbatuar metodat e shoqërorizimit të ndërsjellë të lëndëve.

## **UDHËZIME E REKOMANDIME PËR PUNË PRAKTIKE**

Mësimdhënësi dhe shkolla duhet të angazhohen në krijimin e kushteve optimale për realizimin e suksesshëm të mësimin të përshpejtuar.

- Aplikimi i punës në grupe do t'i motivojë nxënësit për bashkëpunim, tolerancë e disiplinë kolektive.
- Gjatë punës me nxënës do të ketë dallime evidente në kuptimin e talentit të tyre, por mësimdhënia pedagogjike me udhëzime e me rekomandime praktike do t'i inspirojë edhe nxënësit më pak të talentuar, në mënyrë që të mos demoralizohen dhe të shkëputen nga lënda mësimore.
- Zgjedhja e temave më interesante në kuadër të planit dhe të programit mësimor do të ndikojë në arritjen e rezultateve të kënaqshme të nxënësve gjatë orës mësimore.
- Puna praktike zhvillohet në mënyrë efektive për shkak të specifikës dhe limitit kohor në përmbushjen e planit dhe programit mësimor joformal.

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi i duhur dhe matja e kujdesshme e arritjeve të nxënësve në arsimin joformal për këtë lëndë duhet kërkuar në bazë të arritjeve nga:

- Kreativiteti individual i shprehjes së lirë në zotërimin e trajtave më të sakta nga detyrat e parashtruara;
- Aktiviteti dhe përfshirja e nxënësve në punë grupore;
- Origjinaliteti dhe qasja përkushtuese në përfundimin e punimeve.
- Njohja e drejtimeve të artit pamor dhe e komunikimit masiv.

## **TEKSTET DHE MJETET TJERA MËSIMORE**

**Me qëllim të lehtësimit të procesit mësimor, përveç teksteve mësimore, nevojiten edhe:**

*Mjetet dhe materiali mësimor, si:*

- Fotografji, ilustrime, simbole, piktura etj.
- Fotoslajde, kompaktdisqe (CD), kaseta etj.
- Adresa në internet ( [www.art attack.com](http://www.artattack.com), [www.barbie.com](http://www.barbie.com) ).
- Modele të ndryshme (lojëra, kukulla-modele, maketa, forma gjeometrike etj.).
- Lloje të letrave me gramaturë e ngjyra të ndryshme.
- Lloje të ngjyrave (lapsa, akuarel, temper, pastel etj.).
- Brusha, ngjitës, gërshërë, plastelinë, kocka të ndryshme, sapun, tel të butë me mbështjellje plastike, kokrra fasule, oriz, lloje makaronash, lloje tekstilësh etj.

# EDUKATË MUZIKORE

## HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut.

Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e saj duke ia formuar mjedisin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe në ndikimin që ka në të, del rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

Edukata muzikore mundëson:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe të shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale - instrumentale dhe në veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtijshëm, i cili nxit interesim më të gjerë për muzikën, përkatësisht përgatitjen për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

## QËLLIMET

Lënda ka për qëllim:

- ✚ Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- ✚ Të zhvillojë dhe të ngrisë muzikalitetin në vazhdimësi;
- ✚ Të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;
- ✚ Të edukojë për mjedis të shëndoshë tingëllor;
- ✚ Të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të:

### **Muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:**

- këndojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë, sipas imitimit (veshit) dhe simboleve grafike, pa dhe me shoqërim instrumental;
- luajnë në vegla muzikore ritmike dhe melodike (popullore dhe te ORF-it), sipas imitimit dhe simboleve grafike;
- zhvillojnë kulturën vokale (qëndrimi, frymëmarrja, artikulimi, këndimi i bukur dhe shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe dinamikë);
- përmes ligjërimeve dhe lëvizjes zhvillojnë ndjenjën ritmike.

### **Zhvillojnë aftësinë për dëgjim aktiv përjetues dhe analitik të muzikës:**

- vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës , mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjuara;
- dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
- dallojnë cilësitë e tingullit muzikor, lëvizjet e melodive, gradacionet në temp dhe ngjyrimet dinamike gjatë këndimit dhe veprimtarive të tjera muzikore.

### **Zhvillojnë të shprehurit kreativ:**

- nxiten për shprehje të përjetimeve dhe të përfytyrimeve muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore sipas prirjeve individuale;
- nxiten për shprehje kreative ritmike dhe melodike në bazë të imagjinimeve tingëllore individuale.

	Prej lojës dhe përjetimit muzikor kah njohja e vetëdijshe	PËRMBAJTJET TEMATIKO-INFORMATIVE	SHEMBUJT
I N T E R P R E T I M	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmes instrumenteve ose me zë shoqërojnë në ostinato këngë popullore dhe artistike të njëzëshme, të cilat janë të përshtatshme nga përmbajtja, karakteri shprehës dhe ambitusi me aftësitë perceptuese dhe përjetuese të kësaj moshe.</li> <li>• Kultivojnë traditën muzikore kombëtare</li> <li>• Në vegla muzikore (fëmijërore, të ORF-it dhe të tjera) interpretojnë shoqërime dhe kompozime të shkurtra instrumentale.</li> <li>• Ligjërojnë ritmikisht vargje dhe i shoqërojnë ato me lëvizje të trupit dhe me vegla muzikore.</li> <li>• Zbatojnë teknikën elementare të të kënduarit dhe të luajtjes instrumentale me formësim estetik.</li> </ul>	<p>Me muzikë në vitin e ri shkollor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kujtimet muzikore nga pushimet</li> <li>▪ Kori i shkollës</li> <li>▪ Këngët popullore - begatia jonë</li> <li>▪ Përmbledhja jonë e parë e këngëve</li> <li>▪ Përmbledhja jonë tingëlluese</li> <li>▪ Këndi muzikor <i>Kohëzgjatja muzikore</i></li> <li>▪ Muzikën e masim</li> <li>▪ Muzika përmban heshtjet dhe pushimet</li> <li>▪ Urimet muzikore</li> <li>▪ Këngë për ngjarje të veçanta <i>Shtegtimi muzikor</i></li> <li>▪ Këndojmë, interpretojmë, vallëzojmë</li> <li>▪ Këngët dhe kompozimet më të dashura</li> </ul>	<p><i>Këngët</i> Dal nga dal po vjen behari (patriotike). Këngë labe Bleta – didaktike Librat rrinë radhë-radhë –didaktike Viti I Ri B. Mulliqi: Pushimet dimërore Pranvera</p> <p><i>Ligjërimet</i> Tym tym koko tym Vjeshta Nina Nana Ora Shiu pikëlon Rona rona I fuqishmi</p>

		<p><i>Muzika nga brezi në brez</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Këngë të vjetra, veglat dhe vallet nga treva jonë</li> </ul>	
K R I J I M	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallojnë ngjyra tingëllore nga natyra dhe krijimtaria artistike dhe me to shprehin përjetimet dhe imagjinimet e tyre.</li> <li>• Interpretojnë në mënyrë të re këngë dhe ligjërime ritmike në mënyrë përjetuese dhe estetike.</li> <li>• Sajojnë shoqërim me vegla muzikore fëmijërore për këngët dhe ligjërimet.</li> <li>• Plotësojnë ritme dhe melodi dhe përgjigjen në pyetjet muzikore.</li> <li>• Krijojnë melodi të reja për vargjet dhe vargje për melodi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Interpretohen lëvizje në temp e në masë të kompozimeve që i këndojnë dhe i luajnë me vegla</li> <li>▪ Zgjedhin veglën për interpretim ose shoqërim të këngës</li> <li>▪ Zgjedhje e lirë e lëvizjeve</li> <li>▪ për muzikën e dëgjuar</li> <li>▪ Imitimet muzikore</li> <li>▪ Plotësohen mendime muzikore</li> <li>▪ Pyetjet dhe përgjigjet muzikore</li> <li>▪ Krijohen përfytyrime muzikore</li> </ul>	
D Ë GJ I	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjojnë me vëmendje kompozime të ndryshme nga muzika programore dhe absolute.</li> <li>• Shprehin përshtypjet e tyre mbi</li> </ul>	<p><i>Me muzikë përjetohen ngjarj</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Muzikë baleti</li> <li>▪ Përralla muzikore</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. F. Beqiri: Ninula (Piano)</li> <li>2. Z. Ballata: Nënës (Kor)</li> <li>3. V. Gjini: Variacione (Klarinetë dhe Piano)</li> </ol>

M	<p>përjetimin muzikor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcjellin shfaqje muzikore.</li> <li>• Përcjellin ngjarjet kulturore në ambientin e tyre.</li> <li>• Vallëzojnë.</li> </ul>	<p><i>Muzika, lëvizja dhe vallëzimi</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Luajmë vallën</li> <li>▪ Me lëvizje dhe vallëzim shprehim përmbajtjet e muzikës</li> </ul> <p><i>Bisedat muzikore</i></p> <p><i>Me vëmendje dëgjojmë zërat</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zërat e veçantë muzikorë – tingujt</li> <li>▪ Tingujt sajojnë melodinë</li> <li>▪ Kënga përmban tekstin dhe melodinë</li> <li>▪ Instrumentet prodhojnë tingujt të lartë dhe të thellë</li> </ul>	<p>4. M. Kaqinari: Loja e Bariut  5. V.Beqiri:”744S”Kuartet saksofonash  6. M.Mengjiqi: “Valle”(perkusione, piano  7. Gj. Gjevelekaj: Miniaturë, Vallja e qitelisë (popullore)  8. F.Qerimaj: Kabavango, nr. 2 (muz. labe violine klarinet, piano)  9. R.Dhomi: Trio harkor  10. A.Peqi: Valle (flaut e piano)  11. V.Tole: “Ç ’u mbush mali ( kor, piano)  12. Donius Milhaud: Pranvera (piano)  P. Çajkovski: Kënga napolitane (piano)  13. K.S. Sans: Elefanti  14. Verdi: Rigoletto (Ladona Mobile)  Strauss: Radecky (marsh )  R.Schubert: Valsi skocez *</p>
<p>Nxënësit gjatë tërë aktivitetit muzikor shprehin përjetimin e tyre përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe shprehjes letrare.  * Shembujt janë dhënë me mundësinë për t’u zgjedhur për moshat e ndryshme të nxënësve.</p>			

## UDHËZIMET DIDAKTIKO-METODIKE

Edukimi muzikor në klasën III paraqet vazhdimësi dhe thellim të disa komponenteve mësimore të cilat janë punuar edhe në klasët e mëparshme (1 dhe 2), sidomos në pikëpamje të përjetimit të dukurive të ndryshme muzikore. Në klasën e tretë vazhdon të prijë përjetimi i dukurive muzikore gradualisht, duke inkuadruar elementet e notacionit grafik dhe simbolet si risi në fazën parapërgatitore për t'i njohur nxënësit me elementet e shkrimit – leximit muzikor. Me një planifikim të mirë, përmbajtjet programore nga veprimtaritë muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi), të cilat u ofrohen nxënësve, duhet të jenë në përputhshmëri me mundësitë e zhvillimit të tyre të përgjithshëm dhe të atij muzikor në veçanti.

Mësimdhënia muzikore duhet të realizohet duke aplikuar shumëllojshmërinë në procesin mësimor në kuptim të kombinimit të veprimtarive bazë.

Mësimdhënësi do të aplikojë metoda dhe forma aktive të punës, të cilat garantojnë sukses në procesin edukativ-muzikor.

Veprimtaritë mësimore – muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) paraqiten të ndërlidhura dhe janë gati të pandashme, prandaj formulimi i njësive mësimore duhet të kombinohet me së paku dy veprimtari të ndryshme. Kjo duhet bërë jo vetëm për shkak të natyrës së lëndës, por edhe për t'iu mundësuar nxënësve veprimtari aktive, varësisht nga aftësitë individuale të tyre.

Përmbajtjet programore bazohen në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore, të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimimit muzikor.
3. Informacionet për kulturën muzikore të ambientit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

## INTERPRETIMI

Interpretimi si një nga veprimtaritë themelore muzikore që u ofrohet nxënësve realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në vegla muzikore bazohet në:

- Interpretimin e këngëve dhe të lojërave popullore, ligjërimeve ritmike;



- Interpretimin e këngëve artistike për fëmijë;
- Përjetimin e dukurive ritmike e melodike (masat, cilësitë e tingullit, krahasimi i tonalitetit dur dhe mol etj.).

Në këndim zbatohet të kënduarit sipas veshit (imitimi), duke respektuar individualitetin e nxënësve dhe gradualisht zbatohet përdorimi i elementeve të notacionit grafik dhe përmes simboleve. Mësimdhënësi duhet të ketë kujdes në ambitusin e nxënësve dhe të synojë vazhdimisht për këndim të drejtë dhe të bukur, duke respektuar pozitën e drejtë gjatë këndimit, frymëmarrjen e duhur, shqiptimin dhe artikulimin e saktë si dhe inkorporimin e ngjyrimin dinamik dhe shprehjes emocionale.

Luajtja para së gjithash me vegla ritmike zbatohet në shoqërimin e këngëve ose e lidhur me lëvizjen dhe vallëzimin.

## DËGJIMI

Dëgjimi muzikor në klasën e tretë duhet realizuar duke iu përmbajtur objektivave të kësaj klase dhe duke synuar në dëgjim përjetues të shprehjes muzikore të veprës. Procedura metodike e dëgjimit duhet të realizohet me kujdes, duke pasur parasysh kohëzgjatjen përkatëse të veprës në funksion të përqendrimit të vëmendjes si dhe mundësinë për shprehje kreative në bazë të dëgjimit.

Dëgjimet duhet të jenë të shkurtra dhe të shpeshta. Dëgjimi i përsëritur i veprës u mundëson nxënësve të vërejnë dhe të dallojnë gjithnjë mjete dhe elemente të reja nga shprehja muzikore. Gjatë dëgjimit duhet të insistohet në të vërejturit e mjeteve dhe të formacioneve interpretuese, karakterin shprehës të veprës, ngjyrat e ndryshme tingëllore dhe elementet muzikore, si: ritmi, melodia, harmonia (në kuptim të diferencimit të tingëllimës në dur dhe mol). Mësimdhënësi bën përzgjedhjen e veprave për dëgjim nga shembujt e propozuar në programin mësimor, duke i ndërlidhur me përmbajtjet tematike dhe veprimtaritë e tjera (interpretimin, krijimin). Përgatitjet motivuese para dhe pas dëgjimit mundësojnë dëgjim aktiv dhe të vëmendshëm.

## KRIJIMI

Aktivitetet krijuese në këtë klasë kryesisht realizohen përmes lojës kreative, e cila mbetet shfaqja më thelbësore e kreativitetit të tyre.

Lëvizja dhe vallëzimi paraqesin aktivitetet bazë, përmes së cilave nxënësit shprehin përjetimet e tyre muzikore, por inkurajohet edhe shprehja figurative dhe gjuhësore (kushtet e punës krijuese, pozita e arsimtarit).

## **VLERËSIMI**

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në bazë të kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore shkathtësitë interpretuese, dituritë informative, ndjeshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit, sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar gjithnjë, duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe ta inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative, në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara
- këndimi dhe luajtja instrumentale
- diktimet melodike dhe ritmike
- përgjigjet me gojë dhe me shkrim
- prezantimi

Instrumente të tjera të vlerësimit janë:

- testi
- vetëvlerësimi

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në varësi me objektivat e parashtruar.

## FORMAT E VEÇANTA TË OBLIGUESHME TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE

Puna me kor dhe me orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe në orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë të interpretimit muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore edhe në nivelin e shkollës fillore dhe ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënësit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor 2 orë ( në nivelin e parë). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kritere artistike-pedagogjike.

## **EDUKATA FIZIKE DHE SPORTIVE**

(2 orë në javë, gjithsejt 37 orë)

### **HYRJE**

Me planin dhe programin mësimor të edukatës fizike dhe sportive për nxënësit e klasës së tretë arsimit joformal të shkollës fillore është paraparë që të realizohen të gjitha ato që janë me vlerë të posaçme biologjiko-shëndetësore si dhe edukativo-arsimore.

Në bazë të kësaj dhe duke u bazuar në kërkesat, rregullat, metodat, format organizative të punës mësimore, të cilat i kushtëzon didaktika e përgjithshme dhe metodika e veçantë e edukatës fizike dhe sportive, kjo shkathtësi ka vlerë dhe rëndësi të posaçme për kultivimin dhe ruajtjen e shëndetit, sidomos të nxënësve të cilët janë të përfshirë në arsimin joformal në klasën e tretë.

Më organizim dhe shfrytëzim të mirë të edukatës fizike dhe sportive, duke u mbështetur, posaçërisht, në parimet mësimore, përveç ndikimit në zhvillimin e aftësive psikomotorike të nxënësve do të arrihet edhe krijimi i shprehive për ruajtjen dhe kultivimin e të mbajturit të drejtë të trupit si dhe përjetimi i veprimeve lëvizore nga aspekti ritmiko-estetik.

### **QËLLIMI**

Më përmbajtjet programore, që janë hartuar dhe përfshirë në planin dhe programin mësimor për këtë klasë, arrihet:

- aftësimi i nxënësve në aspektin e krijimit të shprehive lëvizore,
- arrihet përshtatshmëria e aftësive lëvizore, e aftësive funksionale të organeve në organizmin e nxënësve,
- të vazhdohet edhe më tutje në zhvillimin e aftësive kreative përmes lojës,

- të vazhdohet në fitimin dhe krijimin e shprehive për mbajtjen e drejtë të trupit,
- përjetim të këndshëm dhe pozitiv të edukimit fizik dhe sportiv,
- respektimin e të arriturave kulturore dhe shoqërore,
- krijimi i shprehive për veprimtari humanitare dhe shoqërore,
- inkurajimi i nxënësve për iniciativë dhe veprim të pavarur, duke pasur parasysh parimet themelore të mësimi.

## OBJEKTIVAT

Përmes përmbajtjeve programore, që janë paraparë të realizohen me nxënës të klasës së tretë të arsimit joformal, duhet të arrihen këta objektiva:

- **Zhvillimi trupor dhe zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale;**
- **Fitimi, perfeksionimi i lëvizjeve natyrore dhe i diturive sportive;**
- **Njohja e vetive teorike të mësimi;**
- **Përjetimi i këndshëm gjatë edukimit fizik dhe sportiv.**

### *Zhvillimi trupor dhe zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale*

- më lëvizje të zgjedhura të ndikohet në mbajtjen e drejtë dhe rritjen e trupit;
- të vazhdohet me ndikimin maksimal në zhvillimin e aftësive motorike, duke i shfrytëzuar format e ndryshme të lëvizjeve, të lojërave elementare, të stafetave dhe poligoneve;
- zhvillimi i aftësive për orientim në hapësirë (TERREN), duke i përvetësuar pozitën e ndryshme të trupit nën ndikim të forcës dinamike të pozitës që e merr trupi;
- të ndikohet në zhvillimin e aftësive funksionale të organizmit të nxënësve;
- zhvillimi i aftësive për përvetësimin e elementeve ritmike dhe të vallëzimit;
- plotësimi i motiveve parësore të nxënësve që janë të nevojshme për lëvizje dhe lojë;

- të ndikohet në funksionimin e drejtë të shprehive higjienike sipas kushteve të jetesës.

*Fitimi, perfeksionimi i lëvizjeve natyrore dhe i diturive sportive*

- krijimi i bazës për përvetësimin e lëvizjeve që do të shërbejnë për zhvillimin dhe përsosjen e diturive sportive;
- njohja me pozitën e trupit dhe marrja e tyre në formë të pavarur;
- marrja e pozitave të trupit dhe ekzekutimi i lëvizjeve trupore në kushte të ndryshme;
- përjetimi i hareshëm gjatë shfrytëzimit të veglave si dhe gjatë manipulimit me rekuizita të ndryshme (topa, topta, litarë, shishe druri, rrathë etj.);
- njohja dhe përvetësimi i elementeve bazë nga atletika;
- njohja dhe përvetësimi i elementeve bazë nga gjimnastika sportive;
- njohja dhe përvetësimi i teknikave të lëvizjeve në lojërat me topa;
- njohja e disa lojërave kreative;
- përvetësimi dhe ekzekutimi i lojërave elementare dhe i lëvizjeve ritmike;
- njohja dhe përvetësimi i teknikës së notit të lirë (krol) kalimi në not 25 m;
- njohja e sporteve dimërore;
- adaptimi i organizmit të nxënësve në kushte me ujë dhe borë.

*Njohja e vetive teorike*

- të vazhdohet me njohjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të veshmbathjes sportive;
- njohja e terreneve sportive dhe e objekteve, të veglave dhe e rekuizitave etj.;
- njohja dhe respektimi i rregullave gjatë organizimit të lojërave elementare dhe sportive;
- njohja dhe respektimi i kushteve dhe i parimeve themelore gjatë shfrytëzimit të objekteve sportive (sallat, terrenet sportive, oborri i shkollës-poligoni, pishina etj.);
- njohja dhe shfrytëzimi i kërkesave dhe i kushteve higjienike për ruajtjen e shëndetit.

*Përjetimi i këndshëm gjatë edukimit fizik dhe sportiv*

- krijimi i bazës për motivim për shfrytëzimin e aktiviteteve trupore, duke arritur, me vonë, ta vlerësojnë rolin e tyre;
- plotësimi i kërkesave për lëvizje dhe përjetimin e tyre gjatë ekzekutimit;
- përmes lojës të arrihet motivimi i nxënësve dhe kënaqësia gjatë të ushtruarit;
- përmes aktiviteteve trupore të arrihet vetëbesimi, shpirti luftarak, guximi dhe qëndrueshmëria shpirtërore;
- përjetimi i mësimit estetik dhe ritmik;
- sjellja korrekte ndaj kërkesave për përdorimin dhe ruajtjen dhe
- zhvillimi dhe përjetimi i marrëdhënieve të shëndosha shpirtërore dhe kulturore mes nxënësëve.

**TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIMIT**

<b>Kategoritë</b>	<b>Nënkategoritë</b>	
1. Lëvizjet natyrore	Ecjet dhe vrapimet, kërcimet, ngjitja dhe bartja, arjet dhe zvarritjet.	10 –27.33%
2. Atletikë	Vrapimi, kërcimet dhe hedhjet	10-27.33%
3. Gjymnastika sportive dhe ritmike	- Ushtrime në dysheme-akrobatikë. Kërcimet. Ushtrime në trarin gjymnastikor. Ushtrime ritmike dhe vallet popullore.	7-19.91%
4. Manipulimet me rekuizita	- Ushtrime me topa, shishe druri, rrathë dhe shkopinjë.	10- 27.33s%
5. Aktivitete të tjera	Ushtrime formimi pa dhe me rekuizita, në çdo mësim. - Shëtitje. Fushim dhe gara.	

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtjet programore	Të arriturat
1. Lëvizjet natyrore	Ecjet dhe vrapimet	Ecje dhe vrapim në forma dhe pozita të ndryshme (hapa të shkurtër, gjatë, shpejt, më ngadalë, në majë të gishtërinjëve, në thembra, pozita lartë, cuc, ndenjor, shtrirë barkas, në ije, shpinë etj.) - lojërat elementare dhe të stafetës.	Nxënësit duhet: Të forcojnë shkathtësitë dhe shprehitë lëvizore të veprimeve më të përshtatshme si dhe ritmikiisht sipas aftësive të tyre në largësi të caktuara - 20 – 30 m.
	Kërcimet	Kërcim i litarit të shkurtër dhe pengesave të ndryshme (stoli dhe trari gjimnastikor, medicinbali,) drunjët, gurët etj.	Të arrijë rezultate më të mira në krahasim me matjen e parë dhe gjatë vitit të dytë.
	Ngjitja dhe bartja	Ngjitja nëpër vegla gjimnastikore të vendosura pjerrazi (stoli gjimnastikor, dërrasa, purtekat, litari, shkallët) drunjët etj. Bartja e peshave të ndryshme (2-3 kg) nëpër vegla gjimnastikore dhe në largësi 6-10 m.	Të realizojnë me përpikëri mënyrat e ngjitjes dhe të bartjes së peshave me një dhe dy duar.
	Varjet	Varja e lirë dhe e përzier nëpër veglat gjimnastikore. (unazat, hekuri, paralelja, shpatullorja, shpinoret, litari, shkallët,) nëpër drunj-lisa etj. - Kalim nga varja e lirë në varje të përzier dhe anasjelltas.	Të realizojnë në formë të drejtë dhe me përpikëri mënyrat e varjeve të lira dhe të përziera, duke iu përshtatur veglave që shfrytëzohen. Të fitojnë shkathtësi dhe shprehi lëvizore, duke vepruar ritmikiisht sipas aftësive të tyre në largësi të
	Zvarritja:	Zvarritja në mënyra dhe nëpër vegla të ndryshme	



		(barkas, ijas, në shpinë, cuc me ndihmën e këmbëve dhe të duarve, vetëm me njëren dore dhe me njëren këmbë, vetëm me këmbë, vetëm me duar etj.	caktuara 6-8 m.
Atletika	Vrapimet	Elementet e vrapimit normal dhe garues-vrapim nga starti i lartë në largësi 10,20 dhe 30 m. Gara në largësi prej 30 m.	Të arrijë kohë më të mirë në krahasim me matjen e parë dhe në vitin e dytë.
	Kërcimet	Kërcim së gjati nga vendi dhe me vrull. Gara në kërcim nga vendi në largësi.	Të arrijnë rezultate më të mira në kërcim së gjati nga vendi në krahasim me matjen e parë dhe në vitin e dytë.
	Hedhjet	Hedhja e tophave 200 gramësh nga vendi dhe me vrull në gjatësi dhe në cak-shenjë (me njëren dhe me të dy duarët. Garë kush më larg, më gjatë dhe më sakët.	Të arrijnë rezultat sa më të mirë në hedhjen e tophave në gjatësi dhe në cak, në krahasim me rezultatet e më parshme.
Gjymnastika ritmike dhe sportive	Ushtrime në dysHEME	- Kaperdimi para dhe kapërdmi prapa. - Vertikalja mbi shpatullore „Qiri“.	T'i kuptojmë pozitat fillestare dhe të fitojmë shprehi lëvizore që i kërkojnë veprimet gjatë të ushtruarit
	Kërcimet	Kërcim mbi arkën suedeze në lartësi 60 cm.	„
	Ushtrime mbi trarin e ulët	Ecje dhe vrapim nëpër tra, kthim për 180° dhe 360°, kërcim nga trari më trup në hark.	„
	Ushtrimet ritmike dhe vallet	- Kërcim drenushë, gallop, kthimet për 180° - lojrat elementare me elemente të lëvizjes ritmike. Vallja popullore nga rrethi shoqëror.	Të arrijnë rezultate më të mira në përsosjen e shprehive lëvizore sipas

	popullore		ritmit që e kërkon teknika e ekzekutimit.
Manipulimi me rekuizita	me topa	Pasimi, pranimi, driblimi (me duar, këmbë, kokë. rekuizita etj.). Pasimi në dyshe dhe treshe. Lojërat elementare mes topa. Gara.	Të kryejnë veprime të ndryshme lëvizore më topa, të godasin në shenjë dhe t'i përvetësojnë dhe t'i zbatojnë rregullat gjatë lojërave, garave.
	Më rrahë	Xhonglimi dhe shfrytëzimi i rathëve për ushtrim të formimit. Lojërat elementare me rrahë.	„
	Më shishe të drurit	Xhonglimi dhe shfrytëzimi i shisheve të drurit për ushtrime të formimit. Lojërat elementare dhe të stafetës.	„
Aktivitete të tjera	Më shkopinj	Xhonglimi dhe shfrytëzimi i shkopinjve për ushtrime të formimit. Lojërat elementare dhe të stafetës.	„
	Ushtrimet e formimit	Ushtrimet e formimit pa dhe me rekuizita në pjesën përgatitore të orës.	Të arrijë forcimin e shkathtësive lëvizore dhe të shprehive me veprime ritmike të përshtatshme të aftësive psikmotorike.
	Shëtitja dhe krosi	Dy shëtitje: në vjesht, në dimër dhe një kros - krosi vjeshtor.	
	Dimërimi	7-10-lojërat elementare në borë, rrëshqitja me saja dhe ski nëpër terrene të përshtatshme. Pastrimi dhe përgatitja e rekuizitave për rrëshqitje.	Të arrihet forcimi i shprehive dhe i shkathësive, lëvizore si dhe përshtatja e organizmit në kushtet me borë.

## **KONTROLLIMI DHE VLERËSIMI I NXËNËSVE**

### **1. Vlerësimi permanent i aftësive lëvizore**

- Pas çdo kategorie të përmbajtjes programore, që është realizuar, të bëhet vlerësimi i të arriturave dhe i rezultateve duke i ranguar nxënësit në tri grupe.

### **2. Kontrollimi-vlerësimi i veçorive antropometrike dhe i aftësive lëvizore së paku dy herë në vit dhe atë:**

- Kontrollimi i të mbajturit drejt të trupit.
- Pesha e trupit (PT) - Lartësia e trupit (LT) - antropometri.
- Vrapim 3X10 m (V 3x10 m).
- Hedhja e topit në largësi 200g. (HT-200g).
- Përplasja e topit për muri 25 sek (PTM-25s.).
- Kërcim nga vendi në gjatësi (KVGJ).

Në bazë të përpunimit të rezultateve dhe arritjeve-ndryshimit nga matja e parë të rangohen nxënësit në tri grupe me qëllim që në të ardhmen të programohet puna sipas rangimit të nxënësve (përparimtarë, mesatarë dhe në nivel bazë njëjtë).

## **UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME**

Duke u bazuar në veçoritë biopsikomotorike të moshës së nxënësve të klasës së tretë, organizmi i tyre është më i aftë t'i përballojë ngarkesat më të mëdha se organizmi i nxënësve të klasës së dytë, kështu që mësimdhënësi, në përputhje me aftësitë e nxënësve, gjatë organizimit të procesit mësimor, duhet të shtojnë kërkesat, konkretisht nëse në klasën e dytë nxënësit kanë vrapuar shpejt në largësi 20 m, tani duhet të vrapojnë në largësi 30 m.

Zgjedhja dhe shfrytëzimi i ushtrimeve duhet të jenë të orientuara, përveç në aftësimin dhe zhvillimin e aftësive psikomotorike-transformimit, edhe në përvetësimin dhe përsosjen e diturive, shkathtësive dhe shprehive lëvizore.

Përveç lojërave elementare, mësimdhënësi, në pjesën hyrëse të orës, duhet të shfrytëzojë, në masë të madhe, edhe format elementare të ecjeve, vrapimeve, kërcimeve dhe zhagitjeve. Kurse në pjesën përgatitore duhet përgatitur dhe ushtruar kompleksin e U.F. pa dhe me rekuizita, së pari, duke demonstruar ai vet. Ushtrimet duhet të jenë më të përbëra, më inensitet më të lartë, më të theksuara dhe në shumicën e rasteve të shfrytëzohen ushtrimet e formimit (U.F.-kompleksi) me rekuizita (topa, shkopinj, shishe të drurit, litar të shkurtër etj.). Një kompleks i U.F mund të shfrytëzohet në disa orë të mësimin.

Në pjesën themelore të orës mësimdhënësi duhet të shfrytëzojë ato forma të punës, metoda, mjete mësimore (vegla dhe rekuizita) duke iu përmbajtur dhe respektuar parimet mësimore, të cilat do të mundësojnë, së pari, përvetësimin e teknikës së ekzekutimit të detyrës lëvizore e pastaj edhe të ndikimit në transformimin e aftësive psikomotorike. Kjo arrihet duke e ndarë pjesën themelore në dy pjesë (formalisht). Në pjesën e parë duhet ushtruar në përvetësimin e njësisë mësimore, kurse në pjesën e dytë puna të organizohet në formë të lojërave apo të garave (lojërat elementare dhe të stafetës).

Gjatë organizimit të procesit mësimor dhet të zgjedhen ato aktivitete motorike të cilat nxënësit i mundësojnë që të shprehë aftësitë e tij kreative nga aspekti lëvizor, kurse gjatë organizimit të lojërave ose garave mësimdhënësi duhet të ketë kujdes se ato duhet të ndikojnë te nxënësit që ata të përjetojnë kënaqësi, hare, vetëbesim, dashuri ndaj shokut, respektim për fitore dhe përjetim të drejtë edhe ndaj disfatës në lojë. Efekti i organizimit të procesit mësimor të edukatës fizike dhe sportive do të jetë më i madhe, nëse mësimdhënësi do ta shfrytëzojë edhe muzikën.

REZYME: Nga e tërë kjo rrjedh se mësuesi (arsimtari i mësimin klasor) duhet të ketë parasysh:

- Qasjen e problemeve në paraqitjen edhe organizimin e procesit mësimor,
- Theks të posaçëm në demonstrimin dhe në punën frontale dhe grupore më nxënës,
- Motivimi dhe inkurajimi i nxënësve për punë frontale, grupore dhe individuale, duke arritur në aftësimin praktik dhe teorik.

## LITERATURA

1. B. Hasangjekaj Edukata fizike dhe sportive 1. - DORACAK, Prishtinë, 2004.
2. Grup Autorësh: Edukata fizike dhe sportive 2. Prishtinë, 2004.
3. B. Hasangjekaj: Metodika e edukatës fizike, Prishtinë, 1998.
4. B. Hasangjekaj: Edukata fizike dhe sportive-1. Doracak, Prishtinë, 2004.
5. M. Koritnik: „2000 lojëra“, Prishtinë, 1998.
6. M. Pirc: „Metodika shkolse shportne vzgoja“, Lublana, 1995.
7. M. Koshniçar: „Edukata fizike e nxënësve të SH. F. I-IV, Prishtinë, 1968.
8. Grup autorësh: „Lojërat didaktike në kopshtin e fëmijëve“, Tiranë,
9. Grup autorësh: „Edukata fizike në shkollë“, Tiranë, 1973.

Tirazhi: 200 copë  
E përgatiti për shtyp  
*SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR* – Prishtinë  
U shtyp në Shtypshkronjën DRUCKART – Prishtinë

Katalogimi në publikim-(CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi mësimor : Për klasën e tretë të mësimit joformal për shkollën fillore / [ Kryeredaktor Isuf Zeneli].- Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : “Druckart”).- 128 fq. ; 24 cm.

**ISBN 9951-450-68-7**